

VENDIM
Nr.966, datë 2.12.2010

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, SI AUTORITET
KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, si autoritet kontraktor, për vazhdimin e procedurave të prokurimit për objektin “Supervizion punime, ndërtim tuneli në aksin Tiranë-Elbasan”.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha